“Gjithë umeti im do të hyjnë në Xhenet, përveç atyre që refuzojnë

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ka thënë: “Gjithë umeti im do të hyjnë në Xhenet, përveç atyre që refuzojnë.” Të pranishmit pyetën: "O i Dërguar i Allahut, e kush refuzon?" Profeti tha: "Kush më bindet mua, do të hyjë në Xhenet, e, kush më kundërshton, ka refuzuar."

[Sahih] [Transmeton Buhariu]

Profeti në këtë hadith na njofton se tërë umeti i tij do të hyjnë në Xhenet, përveç atyre që refuzojnë! Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) pyetën: "Kush refuzon, o i Dërguari i Allahut?!" Kësisoj Profeti iu përgjigj atyre: "Kushdo që i nënshtrohet, e pason dhe i bindet Profetit , do të hyjë në Xhenet. Sa i përket atij që nuk iu bind dhe nuk iu nënshtrua fesë, në fakt ai refuzoi të hyjë në Xhenet me veprat e tij të këqija.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/4947